




Republika e Kosovës - Komuna e Suharekës
Republika Kosova- Opstine Suvareka
Republic of Kosovo-The Municipality of Suhareka



Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim


Nr-DATË/A:	07Nr.167/350-16096 datë: 12.03.2021
REFERENC-Ë:	07Nr.350-16096 datë: 08.03.2021
PËR/TO:	Naser Përteshi Rr.“Ibrahim Lutfiu” Suharekë Numri Kontaktus: [REDACTED]
KOPJE/COPY:	Drejtorisë së Inspeksionit Arkivit të Drejtorisë Arkivit të Komunës
NGA/FROM:	Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim
	Drejtore: Sanie KUQI REXHEPAJ Punoi: Nexhmije LOSHI DURMISHI
LËNDA/SUBJECT:	Aktvendim mbi Leje Ndërtimore

Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim, ka pranuar kërkesën 07Nr.350-16096 datë: 08.03.21 të **Naser Përteshi nga Suhareka**, për Leje Ndërtimore për objektin me destinim Banim individual, në Lagjen e “Silloxha”, për ngastren kadastrale 02887-0, me numër referues të certifikatës: 11-463-48135-20 lëshuar me datë: 14.10.2020 pronë shoqërore në shfrytëzim të Naser Përteshit, ZK. Suharekë. Andaj ky organ pas shqyrtimit të kërkesës ka vendosur si në Dokumentin e bashkangjitur kësaj Shkrese.

• **AKTVENDIM MBI LEJEN NDËRTIMORE**



Republika e Kosovës - Komuna e Suharekës
Republika Kosova- Opstine Suvareka
Republic of Kosovo-The Municipality of Suhareka



Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim

Data: 12.03.2021

Numri i vrojtimit i lejes:

07Nr.167/350-16096

Në bazë të Ligjit për Ndërtim, Nr. 04/L-110, nenet 14, 15, 19, 20 dhe 21, Udhëzimit Administrativ Nr.08/2017 për Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor, Ligjit për Procedurën Administrative Nr.05/L-031, Rregullores mbi Rregullat dhe Procedurat për Ndërtimin e Objekteve 01-Nr-16-423, datë: 26.01.2011, Rregullores për tarifa nga shërbimet dhe veprimtaritë komunale 01Nr-16-9367, datë: 31.12.2014; neni 2, pika 2.1 dhe 2.2, Planit Detal Urbanistik për Lagjen "Slloxha", vendimit mbi ndryshimin e pjesëshëm të PRrU (planeve detale) 01Nr.4181 datë: 12.07.2007, Planit Zhvillimor Urban 01Nr.5820 datë: 05.03.2008 si dhe sipas kërkesës dhe dokumenteve të paraqitura nga **Naser Përteshi nga Suhareka**, DUP lëshon këtë:

A K T V E N D I M

(MBI LEJEN NDËRTIMORE-OBJEKT BANIMI INDIVIDUAL)

Kjo leje ndërtimore i lëshohet:			
Emri:	Naser Përteshi	Nr. Personal:	[REDACTED]
Adresa:	Rr."Ibrahim Lutfiu", "Slloxhë"-Suharekë	Telefoni:	[REDACTED]
Email:	[REDACTED]	Kërkesa Bazë:	Aplikim për Leje ndërtimore: 07Nr.350-16096 datë:08.03.21

Emri i Projektit:	SHTEPI INDIVIDUALE		
Emri i Projektuesit:	"BASHKIMI PROJEKT SH.P.K."- Prishtinë		
Adresa:	Rr.Ahmet Korenica, KL-C16, Hy.1A-Lok.3-4-Prishtinë		
Telefoni:	[REDACTED]	Emaili:	[REDACTED]

Për punët ndërtimore në vijim: NDËRTIM I RI-OBJEKT BANIMI INDIVIDUAL			
Adresa: Rr." Ibrahim Lutfiu", Lagjja "Slloxha"-SUHAREKË			
Zona(t) Kadastrale: Suharekë	Nr.i parc. kadastrale:	GPS Koordinatat e objektit:	
Me numër referues të çertifikatës 11-463-48135-20 lëshuar me datë 14.10.2020, P.SH. në shfrytëzim të Naser Përteshit.	02887-0	Y= 7486216.751; X=4691352.076 Y= 7486211.969; X=4691348.136 Y= 7486211.505; X=4691347.754 Y= 7486206.722; X=4691343.813	Y= 7486203.053; X=4691348.266 Y= 7486194.991; X=4691358.075 Y= 7486205.008; X=4691366.328 Y= 7486213.082; X=4691356.530
Lloji i ndërtimit të propozuar:			
Objekt për banim Individual			

Kategoria e ndërtimeve të propozuara:			
Kategoria I			
Sipërfaqja e përgjithshme Bruto e Objektit:			
627.76 m ²			
Gabariti	240.11m ²	Katshmëria:	P+2
Vija rregullative	Sipas Aktvendimit rreth Kushteve Ndërtimore: 07Nr.35/350-55792, datë: 26.01.2021.	Vija ndërtimore	Sipas Aktvendimit rreth Kushteve Ndërtimore: 07Nr.35/350-55792, datë: 26.01.2021.

P e r s h k r i m i

Me këtë vendim, poseduesit të Lejës ndërtimore **Naser Përteshi nga Suhareka** i lejohej ndërtimi i objektit me destinim banim me etazhitet P+2 duke mos e tejkaluar koeficientin e ndërtimit dhe kushtet tjera të definuara me Plane, Kushte ndërtimore dhe Udhëzime administrative.

Lokacioni i objektit është në kuadër të PZHU-së 01Nr.5820 datë 05.03.2008, konkretisht në Lagjen "Silloxha" në Suharekë, ku sipas gjendjes së planifikuar parcela kadastrale 02887-0 është tokë ndërtimore me destinim Banim i përzier. Objekti do të ndërtohet sipas projektit të hartuar nga byroja projektuese: "BASHKIMI PROJEKT SH.P.K."-Prishtinë.

Objekti ka karakter të përhershëm me katëshmëri P+2. Ndërtimi i objektit të bëhet konform Kushteve Ndërtimore të lëshuara nga ky organ: 07Nr.35/350-55792, datë: 26.01.2021.

Objekti është lejuar të ndërtohet me sipërfaqe në përdheshë: 627.76 m² (sipas kushteve të larcekura)

Kjo Leje ndërtimore lëshohet në bazë të aplikacionit dhe informatave mbështetëse (të ofruara nga ana e palës gjatë tërë procesit të shqyrtimit të saj). Ndërtimi do të bëhet në përputhje me dokumentet teknike dhe juridike të aprovuara për ndërtim të objektit. Çfarëdo ndryshimi i projektit kryesor duhet të aprovohet nga hartuesi i projektit dhe nga ky organ.

Poseduesi i Lejës Ndërtimore është i obliguar që:

- Puna në ndërtim duhet të fillojë brenda një (1) viti nga data e dhënies së kësaj Leje Ndërtimore, përveç nëse zgjatet afati i vlefshmërisë së saj në pajtim me Ligjin.
- Të vendos tabelën informuese në vendndërtim me informata e mëposhtme:
 - Informata mbi Lejën Ndërtimore,Projektuesin,Kontraktuesin dhe Prezantimi grafik i dukjes së ndërtimit.
- Duhet të siguroheni se kontraktuesi në vendndërtim i posedon dokumentet e mëposhtme:
 - Një kopje të kësaj Leje ndërtimore;
 - Nëse punët ndërtimore kryhen nga një palë e tretë, një kopje e kontratës ndërmjet poseduesit të Lejes ndërtimore dhe kontraktuesit;
 - Një kopje e të gjitha dokumenteve të ndërtimit që janë nënshkruar ose vulosur si të "APROVUAR" nga organi kompetent;
 - Projektin Kryesor me të gjitha fazat për nevoja të realizimit të ndërtimit;
 - Dokumentacioni që tregon konformitetin e produkteve të ndërtimit dhe pajisjeve me kërkesat rregullative, Kodin dhe me dokumentet e aprovuara të ndërtimit;
 - Librin dhe ditarin e ndërtimit, që duhet të përmbajnë regjistër të hollësishëm ditor të të gjitha punëve ndërtimore, përfshirë të dhëna të shkruara dhe skematike, që dokumentojnë: datën, vendin dhe rezultatet e testeve të kryera në materialet ose punët ndërtimore; përshkrim të problemeve të hasura gjatë ndërtimit dhe inspektimit dhe mënyrën se si janë zgjidhur;
 - Protokolet e miratuara të nevojshme për aplikim për certifikatë të përdorimit;
 - Të dorëzojë njoftim inspektoratit të Organit Kompetent për fillimin e ndërtimit në shtatë (7) ditë para fillimit të punëve ndërtimore;
 - Të njoftojë organin kompetent për të kryer inspektimet siç kërkohet me ligj dhe akte nënligjore. Këto

inspektime nuk e lirojnë aplikuesin për leje ndërtimore dhe/ose arkitektin apo inxhinierin e licencuar përgjegjës për sigurimin e inspektimeve adekuate dhe mbikëqyrje ditore të punëve ndërtimore.

- Të njoftojë organin kompetent për ndryshimet në dokumentacionin ndërtimor të miratuar nga Projektuesi. Poseduesi i Lejës Ndërtimore duhet të njoftojë organin kompetent për të gjitha ndryshimet në dokumentacionin ndërtimor të miratuar nga projektuesi përveq në rastet kur:
 - o Ndryshimet nuk janë në kundërshtim me Kushtet Ndërtimore, Kodin dhe rregulloret në fuqi;
 - o Ndryshimet në dimensionet e pjesëve të jashtme të ndërtimit nuk tejkalojnë 2% dhe zero presje një(0.1) metër por që nuk tejkalojnë vijën ndërtimore;
 - o Ndryshimet në organizimin e brendshëm janë në harmoni me Kushtet Ndërtimore, kodet dhe rregulloret teknike në fuqi;
- Nëse gjatë punimeve haset në elemente arkeologjike, investori është i obliguar ti ndërpresë punimet dhe të njoftojë organet komunale.
- Obligohet investori që gjatë gërmimit dhe ndërtimit të objektit të bëjë pastrimin e materialit të panevojshëm për punë dhe se të njejtin ta transportojë në deponinë për trajtimin e tyre, në lokacionin e përcaktuar nga Kuvendi i Komunal.
- Pas përfundimit të punëve ndërtimore, të aplikojë për certifikatë të përdorimit në pajtim me ligjin dhe aktet nënligjore.

Arsyetim

Aplikuesi **Naser Përteshi nga Suhareka**, përmes kërkesës 07Nr.350-16096 datë: 08.03.21 ka kërkuar nga organi kompetent lëshimin e Lejës Ndërtimore për ndërtim të objektit me destinim Banim individual, sipas projektit të bashkangjitur. Kjo Leje Ndërtimore bazohet në shqyrtimin e provave:

- Aktvendimi mbi Kushtet Ndërtimore 07Nr.35/350-55792, datë: 26.01.2021 (kopje),
- Pëlqim për largimin e mbeturinave Nr.24/21, datës: 08.02.2021, lëshuar nga NPRM "ECO-REGJIONI"-Prizren, Njësia operative Suharekë,
- Dëshmi për pagesën e taksës sipas njoftimit 07Nr.160/350-16096 datë 11.03.2021, në shumë prej: 2.659.55€, e paguar në IFJB.VLLESA-CO me datë: 06.02.2020, sipas faturës komunale nr.0000673 datë: 10.03.2021,
- Vlerësim për kyqje në rrjetin publik të Ujësjellësit dhe Kanalizimit-Hidroregjioni Jugor Prizren Dega Suharekë, datë: 20.08.2021,
- Pëlqim për kushtet e sigurisë në komunikacion rrugor-nga Inspektori i Komunikacionit Rrugor 09 Nr.473-71696/375 datë: 09.02.2021,
- Pëlqim për rregullim të dokumentacionit teknik, KEDS-SH.A, Nr.155, datë: 18.02.2021,
- Tri kopje të projektit zbatues dhe një kopje elektronike,
- Kopje e planit dhe certifikata e pronësisë,
- Vërtetimin e tatimit në Pronë,
- Kopje e dokumentit Identifikues,
- Ky organ përmes shërbimit të vet profesional pas shqyrtimit të kërkesës dhe dokumenteve tjera përcjellëse, bazuar në Ligjin për Ndërtim Nr.04/L-110, konform PZHU-së 01Nr.5820 datë: 05.03.08 dhe në Planin Detal për Lagjen "Silloxa" ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet e parapara ligjore për lëshimin e Lejës Ndërtimore për ndërtimin e objektit, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

Udhëzim juridik: Kundër kësaj Leje Ndërtimore pala e pakënaqur mund t'i paraqitet ankesë MEA-së në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e dorëzimit përmes këtij Organi.

Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim – Komuna Suharekë

Numri i vrojtimit i lejes 07Nr.167/350-16096 datë: 12.03.2021

Vendimi i dërgohet:-Parashtruesit të kërkesës; Inspektoratit të Komunës; Dosjes së DUP-së

Drejtori i Drejtorisë:
Sanie KUQI REXHEPAJ